



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 15 Prill 2021

Nr: 241

**VENDIM**

**PËR**

**MIRATIMIN E VËZHguesVE AFATSHKURTËR TË KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE TË KOSOVËS PËR VËZHGIMIN E ZGJEDHJEVE PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të neneve 6, 7, e 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe Udhëzimit nr.2, datë 02.02.2021 “Për procedurat e akreditimit dhe rregullat e vëzhgimit të zgjedhjeve nga organizatat joqeveritare shqiptare dhe të huaja, organizatat ndërkombëtare, përfaqësues të shteteve të huaja, mediave dhe subjektet zgjedhore”, pasi shqyrtoi relacionin dhe dokumentacionin e paraqitur, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve,

**VENDOS:**

1. Të miratojë kërkesën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Republikës së Kosovës për akreditimin e 20 (njëzet) vëzhguesve afatshkurtër për vëzhgimin e procesit zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 Prill 2021, sipas lidhjes 1 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të KQZ-së.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 3 (tre) ditëve në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**Ilirjan CELIBASHI**



Data: 15 Prill 2021  
Nr. 241

Për miratimin e vëzhguesve afatshkurtër të KQZ të Kosovës për vëzhgimin e zgjedhjeve për Kuvendin e Shqipërisë të datës 25 prill 2021.